



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:073269

Datë: 03.04.2019

Numri i dokumentit: 00267395

PKR.nr.31/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMLORE NË GJILAN- Departamenti i Krimeve të Rënda, përmes kryetarit të trupit gjykues – gjyqtarit Agim Ademi, me zyrtare ligjore Xhemile Bejtullahu, në lëndën penale kundër të akuzuarit B. G. nga Gjilani, në rr. “Esat Berisha” nr. 23. për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1. të KPRK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda PP.I.nr.13/2019, të datës: 26.02.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më datë 01.04.2019, bie dhe në prezence të palëve publikisht shpalli këtë :

A K T G J Y K I M

I akuzuari B. G., nga babai dhe e ëma e lindur i lindur më datë, në Gjilan, ku edhe jeton, rr. ,,, nr. 23, i martuar, baba i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, pronar i biznesit i kafiterisë ,,, në adresën e njëjte, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Se me datë 19.01.2019, rreth orës 10.25 min, në Gjilan, në rrugën “ Esat Berisha” nr. 23, i akuzuari pa autorizim dhe pa leje valide, e në kundërshtim të ligjit të zbatueshëm për armët, ka mbajtur në pronësi , kontroll, posedim të paautorizuar armën e zjarrtë dhe atë: një pistoletë e llojit ,, Ecol special 99,, me numër serik EV-1173798 ,

e kalibrit 7.65 mm dhe 16 fishekë të kalibrit 7.65 mm të cilat gjatë bastisjes nga ana e Policisë së Kosovës i janë sekuestruar.

Me çka ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-ës.

Andaj Gjykata në bazë të dispozitave të neneve 7, 17, 21, 46, 69, 73, 83, 114 dhe 374 par. 3 të KPRK-ës, dhe neneve 365 dhe 453 të KPPRK-ës.

E G J Y K O N

Të akuzuarin B. G., me dënim me gjobë në shumë prej 600 (gjashtëqind) euro, në të cilin dënime gjobë ka për t'iu llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga dt. 19.01.2019, deri me dt. 12.02.2019.

Pjesën e mbetur të dënimit me gjobë prej 140 euro, i akuzuari do ta paguaj në afat ligjor prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën dënimi me gjobë do ti zëvendësohet me dënim burgu, llogaritur nga 20 euro për një ditë burgimi.

Të akuzuarit B. G., i shqiptohet edhe dënimi plotësues, konfiskimi i armës së zjarrit të llojit Ecol special 99,, me numër serik EV-1173798 , e kalibrit 7.65 mm dhe 16 fishekë të kalibrit 7.65 mm.

Obligohet i akuzuari që ta paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 30 (tridhjetë) euro si dhe shpenzimet e procedurës sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës dhe 50 (euro) për kompensimin e viktimave të krimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda ka paraqitur aktakuzë PP.I.nr.13/2019, të datës: 26.02.2019, kundër të akuzuarit Burim Gagica nga Gjilani, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK-së dhe ka propozuar që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet me dënim merititor sipas ligjit.

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda Arben Kadriu, fillimisht mbeti pranë aktakuzës, deri sa pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit në deklarinimin mbi dënimin shtoi se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është i plotë dhe në përputhje me provat materiale si në aktin akuzues si dhe në pajtim me nenin 248 par.4. të KPRK-ës. I propozoj gjykatës që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe të i shqiptoj dënim merititor sipas kodit penal. Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit të i ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese. Njëkohësisht propozoj që arma e sekuestruar të konfiskohet.

I akuzuari B. G. fillimisht e pranoi fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë dhe se këtë pranim të fajësisë e bëri vullnetarisht pa u ndikuar nga askush dhe pranimi i fajësisë i është aprovuar me aktvendim nga ana e gjykatës. I akuzuari në deklarinimin e tij për dënimin shtoi se pendohem për kryerjen e kësaj vepre penale, premtoj se në të ardhmen nuk do të kryej vepër penale dhe i propozoj gjykatës që mundësisht të më shqiptojë një dënim sa më të butë duke pasur parasysh gjendjen materiale.

Gjykata analizoi provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, dhe atë urdhëresa UGJK.nr.4/2019 e datës 17.01.2019, procesverbali mbi kontrollin e personit dhe banesës e datës 19.01.2019, vërtetimi mbi marrjen e përkohshme të sendeve nr.2018-DHTN-513 e datës 19.01.2019, foto dokumentacioni dhe lista e armëve të konfiskuara e datës 19.01.2019, si dhe vet pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe erdhi në përfundim se me datë 19.01.2019, rreth orës 10.25 min, në Gjilan, në rrugën “ Esat Berisha” nr. 23, i akuzuari pa autorizim dhe pa leje valide, e në kundërshtim të ligjit të zbatueshëm për armët, ka mbajtur në pronësi , kontroll, posedim të paautorizuar armën e zjarrtë dhe atë: një pistoletë e llojit,, Ecol special 99,, me numër serik EV-1173798 , e kalibrit 7.65 mm dhe 16 fishekë të kalibrit 7.65 mm të cilat gjatë bastisjes nga ana e Policisë se Kosovës janë sekuestruar. Ashtu që në këtë mënyrë ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armeve nga neni 374 par.1 të KPRK-ës.

Me rastin e caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit Gjykata pati parasysh rrethanat të parapara me nenin 73 të KPK-ës, dhe si rrethanë lehtësuese gjeti se i akuzuari e ka pranuar fajësinë duke shprehur keqardhje të thellë, pati sjellje të mira në Gjykatë, premtimi i tij se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale. Ndërsa si rrethanë rënduese pati parasysh shkallën e rrezikshmërisë shoqërore duke qenë se posedimi i armës pa leje paraqet rrezik për popullatën, si dhe faktin që në emër të tij evidentohen edhe dy lëndë penale të përfunduara P.nr. 117/07 dhe P.nr. 120/10 me bindje se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 41 të KPK-ës.

Vendimi mbi dënimin plotësues konfiskimi i e armës “Ecol special 99” me numër serik EV-1173798 e kalibër 7.65mm, dhe 16 fishek të kalibrit 7.65, është bazuar në nenin 69 par.1 dhe 374 par. 3 të KPRK-së

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453 të KPRK-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
PKR.nr. 31/19 Me datë.01.04.2019

Zyrtare ligjore
Xhemile Bejtullahu

Kryetari i trupit gjykues
Agim Ademi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimin të së njëjtës, ankesa dorëzohet në dy ekzemplar përmes kësaj Gjykate.